



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/49
Datë: 17.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/ L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L- 016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr.13/19 i datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, ashtu që Pakos së Ringjalljes Ekonomike i shtohet masa 3.7, me tekstin si në vijim:

Masa 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike.

2. Masa 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, do të shfrytëzohet për të subvencionuar importin e energjisë elektrike.
3. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021 mbesin të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/49

Datë: 17.12.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/ L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L- 016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 20,000,000.00 € (njëzet milionë euro) për zbatimin e masës 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas pikës 2. të këtij Vendimi transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213 në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", në nën-programin "Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike" me kod 23300.
4. Obligohet Ministria e Ekonomisë të bëjë transferimin e mjeteve financiare tek Ndërmarrja Publike KEK Sh. A.
5. Kushtet dhe kriteret e shfrytëzimit të mjeteve nga pika 1. e këtij Vendimi përcaktohen në marrëveshje që lidhet në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe KEK Sh. A.
6. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë